

DREJTËSIA

DITARI MUJOR

MINISTRI I DREJTËSISË PARALAJMËRON DREJTORËT E IEVP PËR KALLËZIME PENALE



Ministri i Drejtësisë z. Ulsi Manja ka zhvilluar një takim me të gjithë drejtorët e IEVP në vend dhe me shefat përkatës të policive. Manja ka qenë i drejtpërdrejtë duke tërhequr vëmendjen për një sërë mangësish të vërejtura në punë, si dhe ka paralajmëruar kallëzime penale për zinxhirin drejtues. Ai ka kërkuar rikonceptim t burimeve njerëzore, plane të detajuara për zgjidhjen e problematikave të mbartura, rishikim të udhëzimeve që bien ndesh me vizionin e ri, etj. *Për më shumë linku* [LEXO PËR MË SHUMË](#)

MANJA: NDËSHKIM PËR ATA QË ABUZOJNË ME PERSONAT E DËNUAR ME SHËRBIM PROVE



Gjatë një seminari trajnues me të gjithë drejtuesit e Shërbimit të Provës në Shqipëri, Ministri i Drejtësisë z. Ulsi Manja ka tërhequr vëmendjen për stafin që punësohet dhe mentalitetin e shërbimit ndaj qytetarit. Ai nuk ka hezituar të paralajmërojë ndëshkim për këdo që abuzon me detyrën ndaj personave të dënuar me shërbim prove. Manja ka pohuar gjithashtu mbështetjen e tij ndaj strukturës, si dhe nisjen së shpejti të digjitalizimit të sistemit, si një mundësi për luftën ndaj korrupsionit. *Për më shumë linku* [LEXO PËR MË SHUMË](#)

HETIMI I DREJTORISË ANTIKORRUPSION, TRE ZYRTARË TË ATP KALLËZOHEN NË SPAK



Tre zyrtarë të lartë të Agjencisë së Trajtit të Pronave kallëzohen në SPAK nga Ministria e Drejtësisë. Njoffimin e ka bërë publik vetë ministri z. Ulsi Manja në një dalje të posaçme përballë mediave. Sipas tij ka qenë një hetim disa mujor, shumë profesional i Njesisë Antikorrupsion në këtë agjenci që ka zbuluar një seri shkeljesh të rënda të zyrtares më të lartë të ATP, drejtorit të kompensimit financiar dhe një tjetër punonjësi. Nëpërmjet skemash dhe manovrash abuzuese, ka dyshime të arsyeshme se është prodhuar korrupsion, ku janë përfshirë edhe persona të tjerë, në shkelje të ligjit dhe në kurriz të qytetarëve. Ministri i Drejtësisë theksoi se tashmë i takon SPAK të thellojë hetimin e veprimtarisë së këtyre zyrtarëve dhe të zbardhë plotësisht abuzimet. Për këtë, ai ka treguar gadishmëri për bashkëpunim të plotë të Njesisë Antikorrupsion me SPAK. Po ashtu, Manja ka bërë të ditur edhe bërjen publike në një kohë të shpejtë të disa hetimeve të tjera të njesisë. *Për më shumë linku* [LEXO PËR MË SHUMË](#)

KM UDHËZIM PËR REKURSET NË GJYKATËN E LARTË



Ministri i Drejtësisë, z. Ulsi Manja pas përfundimit të mbledhjes së Këshillit të Ministrave në një komunikim me gazetarët ka lajmëruar për një udhëzim të miratuar, sipas të cilit janë përcaktuar rregullat për heqjen dorë nga rekursat e depozituara në Gjykatën e Lartë dhe të pasqyrtuara ende nga administrata shtetërore në përgjegjësi të Këshillit të Ministrave për çështje me natyrë civile dhe administrative. *Për më shumë linku* [LEXO PËR MË SHUMË](#)

MANJA VIZITON IEVP LUSHNJË DHE BERAT



Ministri i Drejtësisë z. Ulsi Manja informohet direkt mbi problematikën dhe kërkesat nga punonjësit dhe personat në konflikt me ligjin në IEVP Kosovë-Lushnjë dhe Berat. Inspektime edhe në zyrat e Shërbimit të Provës dhe Zyrën e Shërbimit Përmbarimor. *Për më shumë linku* [LEXO PËR MË SHUMË](#)

MINISTRI I DREJTËSISË REFERON NË AKADEMINË E SHKENCAVE



Me ftesë të Akademisë së Shkencave, Ministri i Drejtësisë z. Ulsi Manja ka referuar në Konferencën “Shteti i së Drejtës në këndvështrimin e studiuesve në diasporë”. Manja shprehu vlerësimet e tij për përpjekjet e Akademisë në ngritjen e urave të komunikimit mes institucioneve dhe njerëzve në shkëmbimin e ideve për interesat kombëtare. *Për më shumë linku* [LEXO PËR MË SHUMË](#)

DITA E JETIMËVE, MANJA PRET PËRFAQËSUES TË AGJENCIVE NDËRMJETËSUESE



Në Ditën Kombëtare të Jetimëve, Ministri i Drejtësisë ka pritur disa përfaqësues të Agjencive Ndërmjetësuese. Ai i ka falënderuar ata për punën dhe ndihmën në trajtimin e kësaj shtrese, e cila sipas z. Manja kërkon më tepër mbështetje dhe dashuri. Ai ka siguruar gjithashtu mbështetjen për përmirësimin e kuadrit ligjor për procesin e birësimit. *Për më shumë linku* [LEXO PËR MË SHUMË](#)

PËRVOJA ME REFORMËN NË DREJTËSI, MANJA PRET HOMOLOGUN MOLDAV



Shqipëria është kthyer në një vend nga ku kërkohet eksperiencia e saj në fushën e Reformës në Drejtësi. Këtë qëllim ka pasur edhe vizita e Ministrit të Moldavisë dhe një delegacioni të gjerë shoqëruar në Ministrinë e Drejtësisë shqiptare. Gjatë takimit z. Ulsi Manja u shpreh i gatshëm të ndajë gjithë ekspertizën, kapacitetet dhe vizionin në këtë fushë. *Për më shumë linku* [LEXO PËR MË SHUMË](#)

“MINISTËR PËR NJË DITË” – 10 MAJ “DITA E DREJTËSISË”



Në Ditën e Drejtësisë, Ministri Manja mikpriti disa gjimnazistë nga “Sami Frashëri” dhe i pyeti se çfarë do të bënin ata për parandalimin e krimit tek të rinjtë nëse do të ishin në postin e Ministrit të Drejtësisë. Idetë dhe mendimet e tyre, ishin ku e ku më të sofistikuara se të shumë folësve publikë. Është një brez që e do drejtësinë, kërkon inovacionin, qëndron i informuar, lufton për të drejtën dhe ne kemi detyrën dhe detyrimin ta bëjmë rrugën e tyre të jetës më të lehtë dhe më të aksesueshme. *Për më shumë linku* [LEXO PËR MË SHUMË](#)

MD, NISIN TESTIMET PËR REGJISTRIM NË POLICINË E BURGJEVE



Në ambientet e Ministrisë së Drejtësisë u zhvilluan testimet për kandidatët që kërkojnë të përfshihen në sistemin e policisë së burgjeve. Pjesëmarrja e lartë e tyre, sipas Ministrit të Drejtësisë që vizitoi sallën ku zhvillohej konkursi, është një garanci e mirë se po përgatitet një gjeneratë e re e moshës 30-35 vjeç, e cila do të kombinohet me përvojën e më të vjetërve në këtë profesion. *Për më shumë linku* [LEXO PËR MË SHUMË](#)

EUROPIAN



MINISTRI I DREJTËSISË RAPORTON NË KKIE

Ministri i Drejtësisë z. Ulsi Manja raporton dhe u përgjigjet pyetjeve të deputetëve në Këshillin Kombëtar të Integritetit European. *Për më shumë linku* [LEXO PËR MË SHUMË](#)

MANJA-MCALLISTER, SHQIPËRIA NË RRUGËN E DUHUR PËR HAPJEN E NEGOCIATAVE



Një delegacion europarlamentarësh i Komisionit për Politikën e Jashtme drejtuar nga z. David McAllister janë pritur në Ministrinë e Drejtësisë nga z. Ulsi Manja. Gjatë këtij takimi ata shprehën interes dhe u informuan mbi ecurinë e vetëqendrës, shkollën e magistraturës, luftën kundër korrupsionit, si dhe u shprehën optimistë se Shqipëria është në rrugën e duhur për hapjen e negociatave. *Për më shumë linku* [LEXO PËR MË SHUMË](#)